VENDIM
Nr. 795, datë 14.11.2012

PËR NJË SHTESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2012, MIRATUAR PËR MINISTRINË E FINANCAVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" dhe të nenit 13 të ligjit nr. 10 487, datë 5.12.2011 "Për buxhetin e vitit 2012", me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Financave, në buxhetin e miratuar për vitit 2012, në programin "Menaxhimi i të ardhurave tatimore", në kategorinë e shpenzimeve korente, t'i shtohet fondi prej 25 000 000 (njëzet e pesë milionë) lekësh.
2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit, për vitin 2012.
3. Ngarkohet Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha